



U-POLIS
Nr. 329/23 Prot.
Datë: 24.04.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 29, datë 03.03.2023

PËR
AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË,
DOKTORATË NË “ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM URBAN”, TË
UNIVERSITETIT POLIS

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 03.03.2023, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të tretë, Doktoratë në “Arkitekturë dhe Planifikim Urban”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Doktoratë në “Arkitekturë dhe Planifikim Urban”
- b) Cikli i studimit: Cikli i tretë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 563 datë 19.11.2012
- d) Akreditimi i parë: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 187, datë 15.05.2015
- e) Institucioni që e ofron: Universiteti Polis
- f) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Kërkimit Shkencor
- g) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite
- h) Kredite (ECTS): 60 kredite
- i) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- j) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht
- k) Statusi i diplomës: ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarë-s, Itali.
- l) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 8

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Raportimin e Ekspertëve të Vlerësimit në mbledhjen e Bordit;
- e. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuara e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i akreditimit të parë të këtij programi ka qënë pozitiv, pa rekomandime;
- f. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimit të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të tretë “Doktoratë”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush pjesërisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:

- 1. Syllabuset dhe aktivitetet e planifikuara nuk përputhen me programin e miratuar për vitin e parë të këtij programi studimi.
- 2. Mungesa e një strategjie të qartë që do garantonte vazhdimësinë e pavarur të programit të studimit në rast të ndërprerjes së bashkëpunimit me Universitetin e Ferrarë-s.
- 3. Të dhënat e studentëve doktorantë të mbajtura në sekretarinë e institucionit përfshijnë vetëm aktivitetet e zhvilluara në Shqipëri, dhe jo ato të zhvilluara në Itali.
- 4. Procedura e pranimi të studentëve në këtë program studimi, nuk përfshin kërkesën ligjore sipas së cilës kandidatët duhet të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve më një mesatare më të lartë se tetë.
- 5. Procedura e pranimi të studentëve në këtë program studimi, nuk përfshin si kërkesë specifike njohjen e gjuhës angleze të paktën në nivelin C1 dhe të certifikuar ndërkombëtarisht.
- 6. Projektet e kërkimit shkencor dhe udhëheqësit, nuk kanë buxhete të dedikuara duke i bërë ato të varura nga fondet e institucionit.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Doktoratë në “Arkitekturë dhe Planifikim Urban”, të Universitetit Polis
2. Akreditimin e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **3 (tre)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **02.03.2026**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ



Kryetare

ALEXANDER KOHLER



Anëtar

AYŞEN SAVAŞ SARGIN



Anëtar

TOMASZ JELENSKI



Anëtar

IRAJ HASHI



Anëtar

MAURICE OUDEJANS



Anëtar


LEA YPI

Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ

Anëtar

DARINKA PIQANI



Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shënim: Z. K. Sallabanda dhe Znj. L.Ypi, nuk morën pjesë në këtë mbledhje.

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 29, datë 03.03.2023, "Për akreditimin periodik të programit të studimit Doktoratë në "Arkitekturë dhe Planifikim Urban", të **Universitetit Polis**, janë si vijon:

1. Institucioni, të rishikojë syllabuset dhe aktivitetet e workshopeve me qëllim përmbushjen e objektivave të programit doktoratë të miratuar, duke zhvilluar të paktën 30% të orëve në auditor, si dhe duke përfshirë kohën për studim individual të studentëve.
2. Institucioni, të hartojë një strategji të qartë që do garantonte vazhdimësinë e pavarur të programit të studimit në rast të ndërprerjes së bashkëpunimit me Universitetin e Ferrarës.
3. Institucioni, të mbajë të dhëna në sekretarinë mësimore për vlerësimin e aktivitetet të studentëve doktorantë, të zhvilluara në Shqipëri dhe në Itali.
4. Institucioni, të marrë masa që, kërkesat në procedurën e pranimit të studentëve në këtë program studimi, të jenë në përputhje me kërkesat ligjore, duke përfshirë mesataren e studimeve të ciklit të dytë dhe nivelin C1 të gjuhës angleze.
5. Institucioni, të krijojë një buxhet të vecantë për programin e doktoraturës i cili mund të planifikohet dhe menaxhohet në mënyrë të pavarur me qëllim zhvillimin e projekteve kërkimore ose mbështetjen e grupeve kërkimore.
6. Institucioni, të shohë mundësinë e zgjerimit të listës së partnerëve jo vetëm ndërkombëtarisht por dhe në rajon me qëllim rritjen e mundësive të mobilitetit për personelin akademik dhe studentët.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti Polis**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

